

MASHTRIMI SERB PËR KISHAT E TYRE NË KOSOVË

Serbët, në opinionin ndërkombëtar, kur flasin për të drejtat e tyre mbi Kosovën, ngrenë çështjen e kishave dhe të manastireve serbe në Kosovë. Për t'iu kundërvënë këtij mashtrimi serb, duhet që më parë t'u bëjmë të ditur lexuesve ndarjen e periudhës së historisë së Mesjetës në tri periudha:

1. Periudha e hershme e historisë së Mesjetës përfshin harkun kohor që fillon nga rënia e Perandorisë Romake deri në fund të shekullit XIV. Serbët pushtuan Kosovën në fillim të shekullit XIII, ndërsa në fund të shekullit XIV ata ishin kthyer në vasalët më të bindur të Perandorisë Osmane. Kështu që, i dokumentuar historikisht, pushtimi i Kosovës zë pjesën më të vogël të fazës së parë të historisë së Mesjetës.

2. Periudha e Mesjetës së zhvilluar (nga shekulli XV deri në gjysmën e parë të shekullit XVI). Në këtë periudhë, pjesa më e madhe e popullit shqiptar, në të gjitha trojet etnike, ishte ende e besimit të krishterë.

3. Periudha e Mesjetës së Vonë (nga gjysma e shekullit XVI deri në fund të shekullit XVII).

Franz Babinger-i në "Mehmeti II Pushtuesi dhe koha e tij" Giulio Einaudi, botues, pohon: "Me të drejtë është cilësuar viti 1453 si kufi ndarës midis Mesjetës dhe Kohës së Re".

Vlen të theksohet se gjatë tri periudhave të Mesjetës nuk pati asnjë ankim të dokumentuar nga ana e kishës serbe në drejtim të shqiptarëve.

Kisha serbe, në kohën e sundimit osman, kaloi në pozita tepër favorizuese. Atë e përkrahu edhe veziri i Perandorisë Osmane, serbi Mehmet Sokoloviç, ish-seminarist i një manastiri serb. Popullsia shqiptare gjithmonë i ka ruajtur kishat serbe, madje edhe gjatë periudhës që shumica e saj kaloi në fenë islame. Manastiri i Pejës, i cili qe selia e Patrikanës serbe, mbante

marrëdhënie të ngushta me shqiptarët e zonës malore të Rugovës, e cila u bë strehë e Patrikut Arsen IV, më 1737, në kohën që ai ndiqej nga turqit.

Këta shqiptarë vazhdonin të siguronin me truporje mbrojtjen e Patrikanës, si edhe Manastirin e Deçanit. ("Saga e Kosovës, fokus në marrëdhëniet shqiptaro-serbe", Aleks N. Dragnić dhe Sllavko Todorović, monografi për Europën Juglindore, shpërndarë nga Universiteti i Kolumbias, New-York, 1984). Marco Dogo, në revistën "Identitetet kombëtare ballkanike", me një perspektivë historike, (Ravenë, 1998), duke folur për literaturën historike, që u përket muslimanëve të Ballkanit, pohon: "Me sa dimë, i vetmi rast që është lënë pas dore, është vepra e Çubrilloviqit, shkrimet e të cilit kishin për qëllim të paraqisnin rregullsinë darviniane të modelit të deislamizimit, të miratuar nga shtetet ballkanike në luftën e tyre për pavarësi". Nga sa thamë më sipër, del fare qartë "shpërblimi" që sot i jepet popullsisë shqiptare të Kosovës për mbrojtjen nga ana e tyre të kishave serbe të Kosovës, si dhe minoritetit të tyre në këtë vend në kohën e sundimit osman, nga Serbia e Naçertanies dhe e Çubrilloviqit. Gjatë sundimit osman, në Kosovë kishën serbe e përkrahnin dhe spahinjtë serbë të krishterë. Spahinjtë e krishterë financuan një manastir, që u ndërtua në Plevlja (sanxhaku i Novi-Pazarit). Një spahi tjetër financoi për pikturimin e Kishës së Apostujve të Shenjtë në kompleksin e Patrikanës së Pejës, më 1633. Po kështu, dokumentohet ndihma e dhënë prej dy spahinjve të tjerë Milosh dhe Stojko (Kiel, "Arti dhe shoqëria").

Edhe gjatë sundimit të Perandorisë Osmane respektoheshin kishat serbe. Citojmë Evlia Çelebinë në "Shënime nga udhëtimi" (Sarajevë, 1979, faqe 277). Autori gjendet në tyrben e Sulltan Muratit I në Kosovë, së bashku me Maliq Ahmet Pashën: "Kur e pa këtë tyrbe, Maliq Ahmet Pasha u hidhërua. Unë i gjori thashë: Imzot! Serbët për nder të të mallkuarit Millosh, i cili vrau këtu Padishahun, kanë ngritur tutje në mal një manastir, ku gjenden kandilet e qendisura me margaritarë dhe temianica plot me ambrë me erë të ashpër meshash; me to, kallogjerët ditë e natë shërbejnë mysafirët, që vijnë e shkojnë. Vakëfet e këtij manastiri janë të mëdha dhe të pasura. Turbeja e Padishahut Gazi as ka

vakëf dhe as ka personel të tij”.

Evlia Çelebiu, kur përshkruan vrasjen e sulltan Muratit, pohon: “Nga ushtria doli një i pabesë me emrin Millosh Kobiliq dhe vrau madhërinë e tij sulltan Muratin”. Pas tre shekujsh, Millosh Kobiliqi gëzonte një përmendore, kurse sulltan Murati I një turbe të braktisur.

Mjaft kisha serbe janë ndërtuar para se ta pushtonin serbët Kosovën, madje edhe në Rashë kisha e Shën Pjetrit dhe ajo e Shën Pavlit janë ndërtuar para ardhjes së serbëve, sepse sllavët nuk ndërtojnë kisha vetëm për dy apostuj; por kisha të apostujve, po ashtu, mbishkrimet e gjetura në katundin Drenovë, afër Prepoljes, në gjërmadhat e asaj kisha, janë të shkruara latinisht, çka flet për një kohë para shekullit X. Mbeturinat e kishës së Pustenikut të vjetër në Grykën e Kaçanikut, po edhe ato të kishës së Lipjanit, flasin për një kohë parasllave. Është fakt i pamohueshëm se mjaft kisha në Kosovë, të ndërtuara në kohën e pushtimit sllav të Kosovës, janë ngritur mbi themele kishash të vjetra parasllave. E tillë është kisha e sotme e Shën Prendës në Prizren, që është ndërtuar nga mbreti Milutin në vitin 1307, mbi themelet e bazilikës së vjetër. Për shumë gjërmadha kishash në rrethin e Stalaqit, arkeologët janë të mendimit se ato janë ndërtuar para kohës së Stefan Nemanjës, madje dhe themelet e kishës në fshatin Curlin afër Nishit flasin për ndikime nga Perëndimi. Po ashtu, edhe kishat e luginës së Timokut në Bosnjë, si dhe kisha e vjetër e Prokuplies. Për këtë flet “Historia e Jugosllavisë”, vëllimi I, cituar nga Gaspër Gjini në “Ipeshkvia e Shkup-Prizrenit nëpër shekuj”, 1992. “Është e njohur, shkruan dr. Jahja Drançolli në “Rrënjët e qytetërimit iliro-shqiptar në Kosovë”, “Rilindja”, 10-12 shkurt 1999”, se Mbreti Milutin financoi rindërtimin e kishës së Zonjës Premte në Prizren dhe të Manastirit Graçanica, të njohura si ndërtime paraserbe, të ngritura diku rreth shekujve VI-XI, të cilat, sipas burimeve të rëndësishme, konsiderohen si ndërtime katolike. Po ashtu, është ruajtur e dhëna për Dom Vitën me 30 gurë skalitës (kupto skulptorë). Ky klerik-skulptor ndërtoi manastirin e Deçanit. Ajo që tërheq më tepër vëmendjen këtu është fakti se të gjitha punishtet e njohura të gurskalitësve, si për shembull, ajo e Tivarit, Ulqinit, Kotorrit e Korçullës i mbanin

mjeshtrit shqiptarë. Në fillim të shekullit XIII u ndërtua Kisha e Apostujve. Në të vërtetë, kjo kishë, që sot gjendet në kuadër të kompleksit të kishave të Patrikanës së Pejës, sikurse këto dy të parat, është rikonstrukcion i një ndërtimi të vjetër”.

Në një mbishkrim të viteve 1334-1335, në manastirin e Stefan Deçanit, përmendet protomaxhisteri Vita prej Kotorri, si drejtues gjatë tetë vjetëve të punës ndërtimore në atë kishë. Këto kisha, për të cilat bëhet shumë zhurmë në botë, deri në shekullin XIV nuk kanë asgjë të veçantë serbe. “Ndërtimet kishtare të dinastisë së Nemanjidëve, thotë Jireçeku, kanë stilin e Perëndimit”. Kisha me mermer të bardhë e Studenicës, sipas Kondakovit, është një përmendore me stil lombard të Dalmacisë. Vetë Deçani është një ndërtim i admirueshëm me ndërtesa, ku alternojnë radhët e mermerëve me ngjyrë. Skulpturat-koka njerëzish, kafshësh, zogjsh, shermendesh janë perëndimore”.

Për sa i përket arkitekturës së kishave serbe, Jireçeku vë në dukje te “Civilizimi serb në Mesjetë” (Paris, 1913, f. 75): “Historianët e sotëm të artit dallojnë te Nemanjidët dy periudha - më e lashta është me tipare të arkitekturës romane, ndërsa më e vonshmja është ajo me shkëlqim të madh, me ndikim bizantin”. Arti mesjetar është krejtësisht fetar, nuk u zhvillua në një vijë të njëanshme. Mjaft kisha në Serbi janë të tipit bizantin. Kisha e Shën Kollit të Kurshumlisë na riprodhon tipin bizantin të kishës me kupolë me bazë katrore. Kjo kishë ka si stilin, ashtu edhe teknikën bizantine. Po kështu, kisha e Zicës riprodhon polikroninë e modeleve të Kostandinopojës, kthesat e ndërtuara me tulla kjo kishë i ka si kishat e Greqisë dhe të Maqedonisë, por me navatën e saj të vetme ndjek modelin perëndimor. Kurse te kisha e Deçanit arkitektura serbe largohet më shumë se në çdo kishë tjetër nga modelet bizantine dhe, duke lidhur bazat bizantine me elementet perëndimore, ka krijuar përmendoren e vet më origjinale dhe piktoreske.

Përveç arkitekturës, rëndësia e kishës së Deçanit dëshmohet nga zbukurimet me gdhendje në dy portat, në atë të jugut dhe atë nga perëndimi si dhe në dritaret e fasadës nga perëndimi. Në portën nga perëndimi, paraqitet Krishti në fron mes engjëjve, ndërsa në atë të jugut pagëzimi i Krishtit tregohet në dritaren e

Shën Gjergjit me Dragoin. Ky dekoracion është sipas stilit italian, veçanërisht atë të Pulias (krahinë në Italinë e Jugut); të dyja portat janë vepër artistike e të njëjtit artist, edhe pse porta nga jugu duket më e vjetër. (Sestieri, “Kishat Mesjetare në Kosovë”).

Vlen të përmendet Sestieri edhe për kishën në Sopoçan. Ai thotë: “Në kishën e Sopoçanit (1272-1276), të gjitha pjesët iu shtuan bërthamës fillestare. Ato mbuloheshin nga e njëjta çati, e cila jep qartazi përshtypjen e një bazilike: Ne e shohim në mënyrë të qartë përzierjen (ndërthurjen) mes formës italiane dhe asaj të Adriatikut perëndimor me domosdoshmërinë e shpërndarjes së elementeve bizantine në pjesën e brendshme të kishës”.

“Kjo kishë gjysmë e rrënuar na jep një dëshmi të çmuar mbi marrëdhëniet me Italinë, madje dhe për sa i përket pikturës. Dhe kjo është më e rëndësishme sepse, në përgjithësi, nga artet figurative vetëm skulptura vjen nga perëndimi, ndërsa piktura lidhet me skemat dhe kriteret e artit bizantin. Në Sopoçan, në afreskun “Heqja nga Kryqi”, i cili nga bizantinët ishte trajtuar tashmë me saktësi simetrike në vendosjen e figurës, aty është skena e Marisë së zalisur e ndihmuar nga Gjon (Pagëzori). Për Bizantin, grupi nuk ishte gjë tjetër veçse vendosje pranë e pranë e dy figurave pa ndonjë afërsi shpirtërore, të shkëputur madje dhe në gjestin e mbajtjes dorë për dorë, të demonstruar nga fakti që duart ishin të ndara nga një copë pëlhure. Përkundrazi, këtu, zalisja e Marisë theksohet. Busti i përkulur mbahet nga dora ndihmëse dhe dy duart që takohen, ndahen nga shirita pëlhure, por nuk janë të bashkuara në një kapje ngushëlluese. Paraqitja e këtij grupimi është e guximshme dhe e zgjuar, me efekt të fuqishëm. Krijimi është dramatik, vepra e një artisti të vërtetë, i cili shkon përtej modelit të tij, që vinte nga Italia. Në fakt, në Itali, ky qëndrim ishte shprehur më parë me “Mjeshttrin e Shën Françeskos”, nga Fra. Guljelmo dhe Çimabue.

Në Shën Xhovani Fuorçivita të Pistojas dhe në pjesën e sipërme të Asizit, Fra. Guljelmo dhe Çimabue e kishin paraqitur Marinë të mbajtur nga Gjoni, në një grupim me më pak intensitet dramatik sesa në Sopoçan dhe më pak afërsi të ndjerë shpirtërore. Ata kishin sjellë risi për sa u përket skemave të vjetra bizantine: kontakti i duarve të zhveshura, pa asnjë pengesë. Piktori i

Sopoçanit është frymëzuar nga këto modele, duke kapërcyer përmbajtjen intime dramatike, por kompozimi me një kryq të pikturuar të Muzeut të Sopoçanit, përfaqësimi i të cilit është pothuajse i ngjashëm me atë të kishës së Sopoçanit, na tregon se të gjitha këto piktura, kanë të përbashkët qendrën e origjinës, që është Italia.

Vijojmë më tej me Sergio Bettin-in në “Toka të ribashkuara me atdheun Kosova”, botim i Akademisë Shtetërore të Italisë, Romë, 1942, fq. 133, ku citojmë: “Kisha e Shën Mërisë në Studenica, themeluar më 1191 (mbaruar së ndërtuari më 1196) nga Stefan Nemanja, i cili atje dhe u varros; ka pothuajse të njëjtën planimetri me atë të kishës së Kurshumlisë: domethënë, atë të një bazilike të kthyer me anijatë të vetme, me kupolë dhe narteks; por asaj i shtohen tri kunga gjysmërrethore, dy portikë me hajat, të cilat theksojnë akoma më tepër tiparet tipikisht romanike dhe dalmatine të zbukurimit të muraturës me blloqe mermeri të lëmuar, të harktheve, të shtyllave, të dritareve dhe të portaleve të zbukuruara nga dritare në formë gjysmëhëne me dekore të skalitura.

Shpesh grremçat e varura nën harkthet paraqesin koka njerëzish, kafshë ose lule, meqë asgjë nuk mund të jetë më romanike dhe më larg nga bizantinizmi. Në brendësi, nevojat liturgjike të kishës lindore të çojnë në njëfarë ndarjeje hapësirash të ngjashme me bizantinën. Por aq shumë vazhdon pa ndërprerje forma bazilikalë, saqë me një çati të vetme mbulon anjatën dhe narteksin, duke i dhënë kështu nga jashtë kishës pamjen e një bazilike romanike me tri anijata.

Karakterit perëndimor, dalmatin dhe italian romaik i artit të Rashës është provuar së fundi jashtë çdo dyshimi nga kisha, që ka gjasa të jetë kryevepra midis të gjitha kishave të ngritura në zonën ndërmjet Kosovës dhe Moraçës: kisha e Deçanit, e vendosur në jug të Pejës, në një vend jashtëzakonisht piktoresk, të lartë, midis pyjeve me gështenja dhe me pisha. Kisha u ndërtua më 1327 nga Stefan Uroshi III – i cili, pikërisht për këtë, mori nam dhe kisha mori emrin e tij, kisha e Stefan Deçanskut; përfundoi së ndërtuari në mbretërinë e Stefan Dushanit, i cili e stolisi atë me afreske më 1348. Në këtë kishë pasqyrohet shkolla e arkitekturës

së Rashës me maksimumin e koherencës së bashku me origjinalitetin e saj më të lartë. Autor i ndërtimit të saj ishte një murg françeskan italian, Vita nga Kotori; emri dhe origjina e tij vënë në këtë vepër të mrekullueshme vulën e qenies italiane të gjithë asaj shkolle. (Vepër e cituar f. 140-141)

Sergio Bettini bazuar te Boshkoviçi në skulpturën e Deçanit dhe çështja e zhvillimit të disa cikleve ikonografike në skulpturën mesjetare të Italisë Jugore dhe të Perëndimit, “Aktet e Kongresit Ndërkombëtar të Studimeve Bizantine”, Romë 1940, shkruan: “Kishat e Moraçës dhe Studenicës etj. kanë në dritaret në formë gjymdhënëze të portaleve të tyre dhe në dritaret skulptura shumë interesante, por edhe këtu shembulli më kuptimplotë është dhënë nga kisha e Deçanit, prej skulpturave të shumta të së cilës mbi portalet, dritaret, mbështetëset e harqeve etj. Gjithashtu, kohët e fundit ka dalë në dritë karakteri i tyre italian dhe në mënyrë të veçantë ai i Pulias. (Vepër e cituar, fq. 145).

Po në këtë kohë, vë në dukje Sergio Bettini, Gabriel Millet duke rishqyrtuar pikturat e Ballkanit Perëndimor me zell dhe mjeshteri, në ballafaqimet ikonografike arriti në përfundimin që “Perëndimi i Ballkanit merr pjesë në shijen e Italisë, komunikon në formën shprehëse, zotëron së bashku me të ndjenjën e dramës njerëzore, jep dhe merr, krijon me të gjatë shekullit XIII, në njëfarë mase, të njëjtën fushë”. (f. 150)

Arti në këtë pikturë murale është dinamik, ndërsa në pikturat murale të kishave bizantine është statik, siç shihet në pavijonet, të cilat në Greqi, gjatë shekujve të mëpasshëm, mbetën pothuajse të pandryshuara. Rreth pikturave murale të kishave ortodokse në vendin tonë, pas rënies së Perandorisë së Bizantit, thuhet prerazi se ato i përkasin periudhës postbizantine; në fakt ato i përkasin Rilindjes Europiane, e cila hyri në Kosovë në kohën e pushtimit të saj nga Nemanjidet.

Është për t’u vënë në dukje se veshjet bizantine kishin shumë pak origjinalitet. Për shembull, kostumi bizantin njihej vetëm nëpërmjet pikturave murale të bazilikave të vjetra të Kostandinopojës, Romës, Istrias, Romanjës, Lombardisë dhe nga pikturat në varret aleksandrinë. Madje dhe në ditët e sotme ne e

dimë se sa pak originalitet ka mbetur në këto piktura murale.

Le të citojmë Dom Lazer Shantojën: “Arti i Puljas u përhap në Ballkan nëpërmjet Kotorit dhe Shqipërisë së Veriut, duke krijuar kështu në gjirin e artit bizantin një stil të ri, më të gjallë, më të përsosur, plot me pasion, i cili me pa të drejtë quhej serb ose maqedonas, por që në fakt ishte italian nga origjina. (Qendra e Studimeve Shqiptare në Akademinë Italiane, Dom Lazër Shatoja, AQSh, Fondi 1261, Dosja 610, 1939).

Paule Garde në “Jeta dhe vdekja e Jugosllavisë” (Paris, 1992), dëshmon për gjuhën liturgjike. Për këtë, ai shkruan: “Popujt ortodoksë, bullgarë dhe serbë, përdorin një gjuhë liturgjike vendore, sllavonin, dialekt bullgaro-maqedonas i shekullit IX, i cili u ka shërbyer “apostujve sllavë”, Cirilit dhe Metodit, për të përkthyer shkrimet e shenjta, me anë të një alfabeti të veçantë cirilik.

Në Serbinë e Nemanjidëve mbretëronte, përveç krimit, edhe grabitja. Udhëtarët ishin në rrezik të madh, kur kalonin në tokat serbe të Nemanjidëve. Për këtë, Jireçeku, në veprën e cituar, na bën të ditur se nuk ishin të rralla rastet kur shihje njerëz të cilëve u kishin marrë rrobat e trupit, kur të kapurin e vinin me kokë poshtë ose e linin të prangosur në gropë si ndonjë ari.

Kur na flet për ushtrinë serbe të Nemanjidëve, autori i sipërpërmendur në faqen 76 të veprës së cituar shkruan: “Lufta bazohej, mbi të gjitha, në plaçkitjen e vendeve armike, në shkatërrimin e pemishteve dhe të vreshtave, si dhe në djegien e shtëpive”.

Mbretërit e Serbisë luftonin fenë katolike. Konfliktet midis tyre dhe Papës shkuan duke u ashpërsuar gjithnjë e më shumë. Papa Klementi i kërkoi Milutinit që të lirojë kishat latine, që i kishte okupuar ai e të tjerët. (Augusto Theiner “Monumente të vjetra të sllavëve të jugut”, botim i Akademisë së Shkencave të Sllavëve të Jugut, Zagreb, 1875, I. 127-130). Katolikët persekutoheshin, rriheshin dhe vriteshin.

Vlen të përmendet kurorëzimi i Stefan Nemanjës I nga Papa Onori III. Ai, pasi u pranua si bir i Kishës së Romës, i dërgoi Papës dëshmi besnikërie dhe fill pas saj u kthye tek ortodoksia.

Më 1250, u kthyen në fenë katolike krahinat e Pulatit, Arbërisë dhe Kandavisë. “Ky akt i lavdishëm i pavarësisë kishtare, i deklaruar prej shqiptarëve gegë, shënohej prej analistëve romanë në vitin 1250, gjë që ka ashpërsuar akoma më shumë urrejtjen kombëtare midis Serbisë dhe Shqipërisë”. (Jakob Fallmerayer: “Elementi shqiptar në Greqi”, Mynih, 1857-1861).

Serbët, si dje ashtu edhe sot, kishën e kanë pasur institucion politik. Për këtë citojmë historianin e fillimit të këtij shekulli Cedomil Mijatoviç: “Ndjenjat fetare të serbëve nuk janë asnjëherë të thella dhe të zjarrra. Kishat e tyre janë në përgjithësi të zbrazura, me përjashtim kur zhvillohen festivale shumë të mëdha të kishës, si edhe festivale politike. Serbët e kishës sonë e konsiderojnë kishën si një institucion politik.”

Në vitin 1319, bujarët shqiptarë i dërguan letër Papës Gjon XXII, duke i kërkuar që të ndërhynte për ndjekjet e ashpra, që u bënte Uroshi II katolikëve (Farlati VII, 63). Vetëm Uroshi III, Deçanasi, i përmirësoi kushtet e katolikëve. Theiner-i, në “Monumenta Hungariae” (I, f. 701), përmend letrën e Papa Klementit VI, viti 1346, drejtuar Stefan Dushanit, i cili i bën të ditur se Prizreni, Novobërda, Trepça dhe Janjeva janë nën juridiksionin e ipeshkëvit të Kosovës. Papa, në letrën tjetër të 7 shkurtit 1346, “Monumenta slavorum” (I, 215, Nr. 280), i shkruan Uroshit IV se disa mbretër të Rashkës, paraardhës të Dushanit, kishat e përmendura i kanë mbajtur të okupuara. Papa kërkoi që këto kisha të lirohen prej tij.

Populli shqiptar kërcënohej nga rreziku i greqizimit dhe i sllavizimit, për këtë akademiku N. Jorga pohon se “Shqipëria pa prestigjin e forcën e doxheve të Venedikut kurrë nuk do të ishte shkëputur nga Konstantinopoja; vetë karakteri i racës së saj do të goditej, ndoshta do të përzihej me sllavizmin dhe greqizmin e fqinjëve, kundër karakterit ortodoks të të cilit luftonte prej shekujsh, duke ruajtur kombësinë e vet dhe duke u ndihmuar nga misionarët që vinin nga Perëndimi... Nga vrulli kalorsiak i normanëve italianë dhe nga ekspansioni ekonomik i Venedikut, ajo pothuajse i shpëtoi plotësisht sovranitetit bizantin. Shqipëria u ringjall”. (N. Jorga “Histori e shkurtër e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar, Bukuresht, 1919). Pra, ishte ofensiva

perëndimore ajo që i dha një ndihmë të madhe popullit tonë që të mbante marrëdhëniet e vjetra politike dhe fetare me Europën.

Lidhjet e Shqipërisë me Vatikanin, si dhe historia e saj mesjetare, pasqyrohen zbehtë në kronikat bizantine. G. Petrotta në “Katoliçizmi në Ballkan” (Albania, vëll. I, fashikull III-IV, maj-gusht, 1928), vë në dukje se bizantinëve nuk u interesonte të vinin në pah lidhjet e atij populli me Selinë e Shenjtë, të cilat nuk u dobësuan asnjëherë në atë kohë.

Më 29 janar 1369 bënë betimin vëllezërit Balsha, duke kaluar në kishën katolike. Kjo ndikoi në mbrojtjen e katolicizmit në Shqipëri, çka largonte ndikimin sllav në vendin tonë.

Të bie në sy përkatësia historike e kishave serbe në Kosovë: ato, në shumicën e rasteve, u përkasin shqiptarëve. Car Stefan Dushani filloi rindërtimin e kishës së Deçanit. Ai u detyrua të mbante një njësi ushtarake, sepse vendasit (shqiptarët katolikë) nuk lejonin që mjeshtërit të punonin në faltoren e tyre. (S. Riza: “Shqiptarët dhe serbët në Kosovë”). Pra, është e padrejtë që të mashtrohet komuniteti botëror prej gënjeshtreve serbe, që këto kisha të kenë sot garnizone ushtarake serbe “për t’i mbrojtur” për të realizuar qëllimet e ringjalles të Car Stefan Dushanit(!) Edhe sot i shkon vula car Stefan Dushanit te serbët dhe te rusët.

Për të treguar se sa “properëndimorë” dhe sa e kanë “mbrojtur” kishtërimin serbët, do t’ju bëjmë të njohur vetëm katër nene të Kodit barbar të Stefan Dushanit:

“Ligje dhe rregulla të car Stefan Maqedonasit, adhuresit të Krishtit, autokratit të Serbisë, të Bullgarisë, Hungarisë, Shqipërisë, Hungari-Vllahisë si dhe mjaft vendeve të tjera. Ligje të vendosura me mëshirën e shumë të lartit Perëndi Jezu Krisht në vitin 6757 (1349) në të njëzetin indikt, ditën e ngritjes në qiell të Zotit tonë”.

“Neni 6. Për sa i përket herezisë latine, si dhe besimtarëve të vërtetë që bëjnë pjesë në këtë fe, patriku dhe mitropolitët, po kështu edhe peshkopët, duhet t’u shpjegojnë këtyre të fundit teologjinë dhe shkrimet e shenjtja, me qëllim që të kthehen përsëri në fenë e vërtetë dhe në krishtërimin e vërtetë. Nëse ndokush nuk dëshiron të kthehet dhe të vijë përsëri në fenë e vërtetë, ai do të ndëshkohet me vdekje, ashtu siç është e shkruar kjo në veprat e etërve të shenjtë dhe besimtari i vërtetë, Cari, duhet ta shkullë

nga shteti i tij gjithë këtë herezi. Ai që nuk do të dojë të kthehet në fenë ortodokse, do të humbasë të gjithë pasurinë e tij; në të kundërt, ai që do të kthehet në fenë e vërtetë, do të rimarrë menjëherë të gjithë pasurinë e tij të konfiskuar. Klerikët heretikë të një bashkësie tjetër, që kërkojnë të bëjnë proselitë (njerëz të kthyer rishtazi në një fe tjetër), do të arrestohen, do të çohen në miniera ose do të dëbohen jashtë vendit. Do t'i shenjtëroj kishat heretike dhe do t'i vë në dispozicion të klerikëve të vërtetë, me qëllim që çdo person që ka hequr dorë nga kjo e fundit, të rikthehet në fenë e mëparshme.

7. Protopapët do të lidhen me kishat e mëdha dhe ata duhet të konvertojnë latinët e të gjitha qyteteve të vogla dhe të fshatrave. Nëse gjendet në ndonjë vend një person i vetëm që nuk është besimtar i vërtetë, ata duhet të japin një mësim shpirtëror dhe ta mësojnë çdo të diel në kishë. Çdo i krishterë duhet të kthehet në fenë e vërtetë, siç e urdhërojnë apostujt dhe etërit e shenjtë.

8. Nëse gjendet një klerik latin, që kërkon të kthejë të krishterë në fenë latine, ai do të ndëshkohet me vdekje, sipas parimeve të etërve të shenjtë.

9. Nëse zbulohet një gjysmëbesimtar, që është martuar fshehurazi me një grua të krishterë, ai duhet të pagëzohet vetëm në mënyrë të krishterë (ortodokse - Sh. D.); por nëse ai nuk lejon ta pagëzojnë, atij do t'i merret gruaja, fëmijët, shtëpia; ai do të mposhtet me mizerje dhe do të detyrohet të emigrojë.

10. Nëse gjendet një heretik, duke jetuar së bashku me të krishterët, ai do të damkoset në fytyrë dhe do të dëbohet; ai që e fsheh, do të vuajë të njëjtin dënim".

Më pas, ky car katil i tejkaloi nenet kriminale të Kodit të tij. "Stefan Dushani ndaloi shtetasit e tij, besimtarë të ritit katolik, që të merrnin pjesë në meshën latine. Nëse këta e thyenin urdhrin, u nxirreshin sytë". (Aseman, vëll. V, f. 57, 59).

Në bazë të dokumenteve që disponohen, këtë urdhër e theu garda e tij gjermane, e cila i tha krenarisht me një zë car Dushanit: "Më mirë është t'i bindesh perëndisë se njerëzve". (Chopin, "Provincat danubiane", cituar prej librit "Serbia krishtere", "Studime historike", A. D'Avril, 1897).

Për sa i përket propagandës mashtruese, që kanë bërë serbët për të ashtuquajturën “Serbi e Vjetër” dhe për kodin e S. Dushanit, si dhe dëmet që ka sjellë ajo me keqinformim, mjafton të përmendim “Shtegtim në Serbinë e Vjetër”, (Londër, 1865, të A. P. Irby dhe G. M... Mackenzie). Aty pohohet: “Distrikti që shtrihet në veri-perëndim të Maqedonisë, quhet nga banorët muhamedanë “Arnautllëk”, kurse nga të krishterët “Serbi e Vjetër”; ky vend deri në fund të shekullit XIV bënte pjesë në monarkinë e fuqishme të krishtere, e cila shtrihej nga Danubi deri në Adriatik. Kjo monarki quhej Serbi, ajo mbeti në dorëshkrime, piktura dhe arkitekturë së bashku me Kodin e ligjeve, (Kodi i S. Dushanit), i cili tregon saktësisht se ka qenë në të njëjtin nivel me ato të shteteve të krishtere të sotme” (No comment).

Sllobodan Millosheviçi zbatoi pikë për pikë Kodin e Stefan Dushanit. Mjafton që në vend të togut të fjalëve “herezi latine”, të vendoset togfjalëshi “herezi muslimane”.

Për gjendjen e popullsisë shqiptare në atë kohë na flet Brocardus Monacus, i cili shëtititi disa vise të Shqipërisë dhe i paraqiti një relacion princit Filip Valua, në vitin 1332. Citojmë disa rreshta nga origjinali, të botuara në “Historia e kryqëzatave...” (Ka mundësi që autori të jetë Gulielm Adami, kryepeshkopi i Tivarit. A. Dysellier-i është i mendimit se është ai vetë): “Et quia dicti, tam Latini, quam Albanenses, sub jugo importabili et durissima servitute illis odiosi et abhominandi Sclavorum dominii e sunt opressi, populus scilicet anguariatus, clerus dejectus et minoratus...”. (“Këta popuj, si latinët ashtu edhe shqiptarët, janë të shtypur në mënyrën më çnjerëzore nën të padurueshmen dhe tepër të ashprën skllavëri, dhe tepër të neveritshmin dhe të urreyerin sundim të sllavëve (serbëve - Sh. D.). Sigurisht, është një popull që urrehet nga sllavët (serbët), një kler i përbuzur dhe i poshtëruar...”).

“Peshkopët e tyre dhe priftërinjtë shpesh gjenden në pranga, fisnikët e tyre të shpronësuar... Prej tyre, të gjithë së bashku ose individualisht, mendojnë se ata do t’i shenjtëronin duart, duke i ngjyer me gjakun e shpatave të sipërpërmendura”. Kështu shkonin serbët me shqiptarët; këtu e ka burimin urrejtja për njëritjetrin para se të vinin osmanët. Shqiptarët kishin të drejtë t’i

urrenin serbët, sepse ata u sollën skllavërinë me të gjitha të këqijat që sjell ajo, kur robëron një popull.

Mjaft historianë serbë mbajnë një qëndrim të padrejtë ndaj Kishës Katolike, gjatë sundimit të Nemanjidëve; arsyetimet e tyre janë pa baza. Klerikët katolikë, sipas tyre, janë fajtorë, sepse tregojnë realitetin! Citojmë njërin prej tyre: “Deri në këtë kohë Filip Valua kishte halle të tjera dhe nuk merrej me pushtimet territoriale në Ballkan”. Ndërsa Guljelm Adami, pjesëtar i qeverisjes së Filipit të VI, pohon:

“Shqiptarët e sotëm gjatë bregut Adriatik janë të shumtë, me që ky kryepeshkop katolik paska pasur 15 mijë veta që mund t’i merrte nën armë. Atëherë e tërë popullsia shqiptare kishte 150 mijë banorë. Prej kësaj del se Kisha Katolike bregdetare mbante qëndrim armiqësor ndaj serbëve”. (“Historia e Car Dushanit”, e shkruar nga dr. Vladimir Nikoliq-Zemunski, ish-anëtar i Parlamentit).

Gjatë sundimit të dinastisë së Nemanjidëve në Kosovë është përdorur dhuna fetare. Për ta ilustruar këtë, citojmë prof. Skënder Rizën: “Shqiptarët, para se të futeshin nën sundimin e shtetit serb të Nemanjidëve, i takonin kryesisht fesë katolike. Mirëpo, gjatë sundimit serb, sidomos në kohën e Car Stefan Dushanit, pozita e shqiptarëve u keqësua. Një pjesë e tyre, nën presionin e inkuizicionit të shtetit serb, u detyrua të kalonte në fenë ortodokse, ndonëse këta ortodoksizmin e pranuan sa për sy e faqe.”

K. Jireçeku në “Historinë e Serbisë” (I. Gotha, 1911, f. 387-389) thekson “Patriku i Konstandinopojës, Kalisti, anathemoi perandorin e ri (Stefan Dushanin -Sh. D.), patrikanën e Pejës dhe klerikët e saj.”

Për të treguar se Stefan Dushani vuante nga kryevesi i të gjitha veseve, mosmirënjohja (përcaktim shekspirian ky), citojmë një nga bëmat e tij, nxjerrë nga “Japigia”, organ i përfaqësimit mbretëror “Atdheu”, Bari, 1939. Dokumenti flet për dhënien e një të ardhure vjetore, nga ana e këtij cari serb, Bazilikës së Shën Kollit në Bari: “Nipi i Uroshit, (Stefan Uroshi II, 1282-1321 - Sh. D.) Stefan Dushani, duke pasur devotshmëri për gjyshin e tij, Urosh, dhe babain e tij, Stefan, (Urosh III Deçanski, 1321-1331 - Sh. D.), i cakton Bazilikës së Shën Kollit një të ardhur vjetore prej

dyqind perperesh, shumë kjo, që i merrej çdo vit si taksë qytetit të Raguzës, për t'i harxhuar për qirinjtë, për kultin hyjnor, që bëhej për përshpirtjen e gjyshit dhe të babait dhe për shëndetin e vetë të birit dhe të gruas së tij". Kjo diplomë iu dha asaj bazilike më 30 gusht 1346. Hipokrizia e mbretërve serbë këtu mbërrin pikën kulminante. Babai i Car Stefan Dushanit vritet nga vetë i biri dhe pastaj car Stefani merr dhe paguan taksat e një qyteti tregtar, siç është Ragusa (Dubrovniku), bazilikës së Shën Kollit, që ky shenjtor të ndërmjetësojë te Shën Pjetri, që shpirti i të atit t'i transferohet nga ferri në parajsë. Kësaj i thonë: të vret dhe pastaj të paguan përshpirtjet! Shtojmë se këtij perandori i drejtohet me adhurim Zhirinovski, që thotë: "Ja, një vend i vjetër, që ka një perandor në qiell. - Serbi, nëna jonë e shtrenjtë, ti na ke dhënë jetë të gjithëve. Rroftë Serbia!".

Këtij perandori i falet populli serb, duke i paguar përshpirtjet me paratë që u merrte kosovarëve para vitit 1999.

Në dokumentin 408, me titull "Grykat e Kotorit para 9 majit 1661", relacioni i mbretërisë së Serbisë, shkruar nga peshkopi i Shkodrës, Pjetër Bogdani, marrë nga libri i Marko Jakovit "Misionet katolike në Ballkan gjatë luftës së Kandias (Kretës)", vëll. II, Qyteti i Vatikanit Biblioteka, 1992. Autori, vë në dukje se Mbretëria e Serbisë përbëhet prej tre sanxhakësh: Kryesori e ka qendrën në Shkup, i dyti në Prizren, kurse i treti në Prokupie. Në tërë Mbretërinë e Serbisë gjenden 13 kisha dhe tri kapela. Këto merren me kujdesin e shpirtrave dhe vijnë si më poshtë: kapela e qytetit metropolitan të Shkupit, që gjendet në rrëzë të malit Orbelo. Qyteti i Shkupit numëron 40 mijë shtëpi; prej tyre 20 shtëpi janë të krishtera. Meshat zhvillohen në një kishë të vogël private; prifti i kësaj është dom Gjergj Lumpsi.

2. Kisha e Shën Mërisë të Prizrenit, që ndodhet në mes të këtij qyteti. Pjesa më e madhe e të krishterëve të këtij qyteti janë në gjendje të mirë dhe mjaft të instruktuar në fe, bëjnë tregti me Hungarinë dhe, nga përkushtimi që kanë ndaj kishës, sjellin gjithçka që është e nevojshme për kultin hyjnor. Famulltar i kësaj kishe është don Gregor Mazreku.

3. Përballë qytetit të Prizrenit gjendet famullia e Hasit, e përbërë nga tri fshatra, vijnë me relacionin e sipërpërmendur:

“Këtu nga persekutimet e Shkodrës, rëndimet e taksave dhe ikjet e besimtarëve kaluan në pabesi të krishterët; nga 20 shtëpi katolike mbetën vetëm gratë dhe lëneshat, që nuk paguajnë tributin, këtu duhet bërë një punë e madhe me vajzat e reja e të varfra krishtere dhe me baballarët e tyre, që i martojnë ato forcërisht.

4. Në Gjakovë gjenden 1000 shtëpi turke (lexo: shqiptarë muslimanë) (shën.Sh. D.) dhe një kishë e vogël që mban emrin e Shën Pjetrit. Këtu shërbente famullitari dom Primo Paoli, i cili ka vdekur pak kohë më parë nga murtaja. Nga kjo famulli varen disa fshatra rrëzë disa malesh.

5. Në Janjevë gjendet kisha e bukur e Shën Kollit, me një shtëpi të famullitarit përballë. Famullitari, Lluka Daba, ka zëvendësuar dom Gjin Bardhin, misionar i Kongregacionit të Shenjtë, që ka vdekur nga murtaja.

6. Novomonte (Novobërda) ka dy kisha, njëra është e Shën Mërisë, që ndodhet një milje afër qytetit, kurse tjetra e Shën Kollit, që gjendet në qytet.

Kjo kishë ndodhet në gjendje të mirë për t’u frekuentuar nga besimtarët. Për shkak të mungesës së priftërinjve, gjatë këtyre dy viteve që mbretëroi murtaja në Serbi, ky vend ka qenë administruar nga vetë kryepeshkopi (Andra Bogdani). Pak kohë më parë ka ardhur si famullitar Jordan Kumriçi

7. Kratova është vend i minierave të arit dhe i metaleve të tjera. Ky qytet ka një famulli, që qysh prej dy vjetësh është pa famullitar. Në këtë vend, pohon Pjetër Bogdani: “Gjendet një kishë madhështore, ajo e Shën Mërisë. Thuhej se në altarin e saj të madh gjendej një trup shenjtor. Kanë dashur turqit që ta bënin xhami, por Perëndia për mrekulli e ruajti. Do të ishte mirëbërësi e madhe të mos lejohet të zhduket vendi, që perëndia me mënyra të jashtëzakonshme kërkon ta mbrojë. Këtu pranë ndodhen 15 shtëpi katolike.

8. Trepça është vend minierash. Ka një kishë të madhërishtme, që quhet Shën Pjetri. Nga shtimi i taksave, thuhet se quhej famulli e rrënuar; përreth saj kanë ngelur vetëm 8 shtëpi katolike, pasi të tjerat kanë ikur. Në këtë kishë gjenden veshje të bukura për t’u përdorur nga priftërinjtë në funksionet e shenjta,

si dhe vazo për t'u përdorur nga ata në meshën e shenjtë, por nuk ka kush t'i përdorë.

9. Mali i Zi ka rreth 50 shtëpi katolike; gjendet midis maleve dhe ngacmohet nga hajdutët. Në Mal të Zi janë vrarë mjaft famullitarë. Në këtë vend gjendet kisha e Shën Gjergjit, e administruar nga murgu françeskan Bernardino, që është vendas.

10. Prokupja është kapelani e mbajtur nga tregtarët raguzanë. Në këtë vend gjenden 15 shtëpi katolike.

11. Novipazari është, gjithashtu, kapelani tjetër e tregtarëve të Raguzës. Në këtë vend, nuk ndodhet asnjë shtëpi katolike, por ka vetëm dyqane, ku të sipërthënë të ushtrojnë trafikë, kanë kishë dhe kishëza, që kujdesen për shpirtrat e njerëzve; gjenden edhe tri kishëza të tjera, nën kujdesin e Novomontes (Novobërdës), ku shërbehet ndonjëherë në vit.

Nga libri "Deformizmi në historiografi", New York, 1996, i Prof. Muharem Crabregu citojmë dy kisha të Kosovës:

Kisha e Gashit (Deçanit)

Kisha e Gashit, e ngritur në pjesën perëndimore të Deçanit (që thirret sipas emrit fisnor Gashi ose vendbanimit Deçan), përfaqëson një ndërtesë të madhe të rrethuar me mure të larta. Ajo është e vendosur në rrëzë, po ashtu të Alpeve të larta shqiptare, në bregun e djathtë të Bistricës, që ballafaqohet me grykën e Deçanit. Në fakt, pjesa perëndimore bjeshkore është e njohur për blegtori (Kullota të gjera bjeshkore) dhe prodhimin e lundrave, ndërsa pjesa lindore është një hapësirë e çeltë e Rrafshit të Dukagjinit.

Në pikëpamje arkitekture, ajo paraqet një kompozitë të stilit bizantin (Kupa), asaj gotike (në lartësi të Kishës Katolike të pjesës kryesore dhe të Romaneskes (trajta e dyerve dhe dritareve).

Arkitekti i kësaj kishe ishte prifti françeskan Vita nga Kotori, që duke iu falënderuar mbrojtjes dhe kujdesit të shqiptarëve gjatë kohës osmane, qëndron në gjendje të mirë.

Thirrja tradicionale popullore ndër shqiptarët është kisha e Gashit, për shkak se ajo u ndërtua në pronën e Gashëve, që

mbizotërojnë në Deçan dhe Cërabreg.

Sot fisi Gashi u përket tre religjioneve. P.sh., në Pejë atë si mbiemër e mbajnë familjet muslimane, katolike dhe ortodokse (Gashiq-i)

Pikturimet freskore, si dhe dekorimet interiore dhe eksteriore janë prodhim i mjeshtëreve bizantinë të ushtruar në Kostandinopojë.

Një lambradar i madh metali qëndronte varur në nënkupën veriore, që ishte dhuruar nga mbreti i Shqipërisë, Skënderbeu.

Për manastirin e Deçanit citojmë Mark Krasniqin: “Manastiri është në territorin e katundit Deçan, kështu që edhe ai është pjesë përbërëse e tij (Megjithëse i larguar nga dy km). Pra, ai është komshi i të gjitha shtëpive të tjera, kështu që edhe nga ky fakt ai gëzon respektin dhe përkrahjen e zakonshme të fqiu. Mirëpo, e gjithë popullsia e Deçanit ka qenë dhe është edhe tash e kombësisë shqiptare, e besimit musliman (përveç disa familjeve të kolonistëve malazezë) Kështu, kisha është fqinjë e familjeve shqiptare. Sigurisht, në çdo mjedis tjetër etnik e fetar, ky fakt do të mjaftonte që popullsia e vendit të ketë ndaj tij qëndrim armiqësor dhe ta shkatërrojë me themel posa t’i jepet rasti. Përkundrazi, në popullsinë shqiptare, në mjedisin e së cilës ndodhet manastiri i Deçanit, edhe ky fakt ka ndikuar që të kenë më shumë kujdes ndaj tij dhe ta mbrojnë me vendosmëri në situata kritike – sepse nderi dhe burrëria tradicionale shqiptare, kërkojnë që t’i jepet ndihmë çdokujt që është ngushtë dhe që nuk është në gjendje të ndihmojë dhe të mbrojë vetveten.

Shqiptarët i kanë ruajtur e mbrojtur kishat e manastiret serbe në Kosovë, edhe atëherë kur organet qeveritare dhe kishtarë serbe bënin të gjithë të zezat dhe krime të pashoqe kundër popullit shqiptar. Kështu p.sh., edhe gjatë sundimit turk, Patrikana e Pejës, kisha ortodokse serbe ka pasur privilegje shumë të mëdha nga vetë sulltani, i cili me ferman e kishte autorizuar patrikun e Pejës që të sundojë mbi krishterët e Ballkanit, përkatësisht edhe mbi katolikët shqiptarë në Kosovë. Nga raportet e shumta të misionarëve katolikë, dërguar Romës për gjendjen e kishës në këto vise, shihet se katolikët shqiptarë në Kosovë kanë qenë më

në hall nga kisha ortodokse serbe se sa nga pushteti turk. Në kushte të tilla, shumë shqiptarë të këtij besimi kanë qenë të detyruar ta ndërrojnë fenë e kombësinë". (Gjurmime albanologjike, folklor dhe etnologji, Prishtinë, 1989)

Kisha e Ulpianës

Kisha e Ulpianës (e quajtur e Lipianës në mesjetën e vonshme dhe sot e Graçanicës) është ngritur në rrëzë, në pjesën lindore të hapësirës urbane të Ulpianës, ku kemi gjerësinë më të madhe të Fushës së Kosovës.

Materiali ndërtimor shihet qartë se është marrë i gatshëm nga gërmadhat e Ulpianës klasike; në muret e kishës fare mirë shihen gurët mbi varre me shkrime latine, d.m.th. të kohës romake, si edhe tullat dhe rrasat.

Kisha e Ulpianës merret si një model i përsosur i arkitekturës bizantine përkrah origjinaliteti dhe bukuria.

Ky manastir është quajtur edhe i Lipianës (një trajtë e shkurtuar e Ulpianës) luajti një rol të rëndësishëm duke qenë seli e arkipeshkëvisë nga koha e themelimit qysh nga koha romake dhe më vonë gjatë kohës bizantine.

Originaliteti i pikturimit freskor është i paktë. Pikturat e afreskat janë ripërtëritë dhe ndërruar gjatë shekujve.

Heroi Kombëtar, Skënderbeu, ia dhuroi emblemën e artë me simbol shqiponjën dykrerëshe Kishës së Ulpianës.

Manastiri i Ulpianës qe ngritur në afërsi në pjesën lindore të "res publica Ulpiana – postea Justiniana Secund", duke përfaqësuar monumentin më të bukur të ndërtuar nga perandorët bizantinë.

Kjo faltore u ndërtua në vendin e Ulpianës antike, si quhej në kohërat ilire dhe romake, dhe Justiniana Secunda qysh nga koha e Justinianit të Madh.

Kjo kishë bizantine qëndron mbi themelet e një faltoreje, që u ngrit në kohën e Dioklecianit mbi varrin e dy martirëve të hershëm të krishterë.

Vëmë në dukje se mjaft bukur e përshkruan Millorad

Tomaniqi në “Kisha Serbe në luftë dhe luftërat brenda saj” (përkthyer nga Rustem Gjata, dhe Esat Myftari) bashkëpunimin e kishës serbe me regjimin e Milosheviqit. Për këtë, jepen të dhëna të sakta; aty flitet qartazi se gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë nuk duhen veçuar peshkopët serbë me në krye kryepeshkopin Pavël nga krimet e kryera nga serbët e Millosheviçit.

Për këtë, Radovan Karaxhiqi shkruan: “Që nga fillimi i vitit 1994, marrëdhëniet midis kishës dhe shtetit i vlerësoj si të jashtëzakonshme. Kleri ynë është i pranishëm në të gjitha meditimet dhe vendimet tona, kurse zëri i Kishës dëgjohet si zëri i autoritetit më të lartë.”

Vetë Zhelko Razhnjatoviqi thotë se dashamirësi më i madh i Patrikanës dhe komandanti i tij suprem ishte personalisht patriku Pavël.

Në Jugosllavi shkëlqenin “Tri A-të”: peshkopët Amfillohije, Artemije dhe Atanasije. Këta peshkopë ishin mefistofelë me pëlhura të zeza:

Peshkopi Amfillohije ka mbrojtur haptazi ekzistencën e shtetit, në krye të të cilit ndodhej dhëndri i tij, Vojislav Koshtunica. Udhëheqësit serbë, pa përjashtuar këtu parinë e tyre fetare, shkojnë sipas parimit të Gëbelsit: “Thuajeni gënjeshtër shumë herë, pastaj përsëriteni, se njerëzit mund ta besojnë” dhe “njerëzit e zakonshëm janë përgjithësisht më primitivë nga sa mund të mendojmë. Propaganda gjithmonë duhet të jetë e thjeshtë dhe të mund të përsëritet.”

Dhe kur populli serb, me gjithë përpjekjen e madhe të parisë së tij, përjetoi një nga dështimet dhe rëniet e tij më të mëdha në histori, u desh përsëri të bindet se kjo ishte shenjë e veçantisë së drejtësisë së tij. Mitropoliti Amfillohije, për shembull, ka thënë: “Zoti kërkon prej këtij populli diçka të madhe, posa e vendosi në fokus të ngjarjeve botërore” (Millorad Tomaniq, “Kisha serbe në luftë dhe luftërat brenda saj”).

Vlen të theksohet se Arkimandriti Artemije u shugurua peshkop i Rashkës e i Prizrenit, në qershor të ’91-shit, dhe shugurimi i tij u shoqërua me orën letrare, ku Radosllav Ratanoviqi, poeti i ri, shkroi të famshmin panegjirik “Himni në lëndinë”, ku lavdërohej

pa fund Sllobodan Milosheviqi. Po ashtu, Atanasije Jevtiqi thotë: "Populli serb sërish është me kryq në krah dhe në Kosovë e Metohi, edhe në Dalmaci, në Krajinë, në Sllavoni, në Bajina, Lici, Kordun, Srem, Bosnje dhe Hercegovinë. Ky popull është mësuar të mbajë kryqin në krah, sepse ky është fati ynë. Zoti na ndihmoftë që edhe tash këtë kryq ta mbajmë me dinjitet, siç kemi bërë përherë. E të themi ndryshe nga ç'pati thënë Çifutja e urtë për muslimanët smirëzi e agresivë: "Ju falim për vrasjet që na keni bërë, por nuk mund t'ju falim nëse na detyroni t'ju vrasim."

Përse kryepeshkopi Irenje dhe peshkopë të tjerë serbë, miq dhe frymëzues të kriminelëve, që shkuan në Hagë, të mos denoncohen dhe të shkojnë edhe ata në Hagë? Kryepeshkopin Pavël dhe peshkopin Artemije i njeh mirë populli i Kosovës se aty ata kanë punuar me vite. Çuarjen në Gjykatë të Hagës dhe dënimin e këtyre kriminelëve barbarë e kërkojnë të masakruarit e popullit të Kosovës, si edhe të popujve të tjerë të ish-Jugosllavisë. Në Hagë duhet të shkojnë këta shërbëtorë të satanait.

Më 21 nëntor 2009, në gazetën "Le courier des Balkans", u botua intervista me titull: "Serbia, e tërë kisha duhet reformuar", dhënë nga shkrimtari, përkthyesi dhe eksperti i sociologjisë dhe ideve, Mirko Dorderić. Po citojmë disa fragmente nga kjo intervistë:

"Çfarë roli ka pasur kisha gjatë luftës?

- Kisha serbe nuk ka qenë vetëm një dëshmitare, por ka qenë dhe një mbështetëse e regjimit. I ka dhënë logjistikë shpirtërore regjimit, me qëllim që ai të drejtonte mirë luftën.

- Në çfarë gjendje ndodhet kisha serbe në ditët e sotme?

- Sipas kushtetutës, ne jemi një shtet laik. Megjithatë, roli i kishës është mbizotërues. Shoqëria serbe është plotësisht e klerikalizuar. Kisha është kudo: në shkollë, ushtri, polici...

Luan të njëjtin rol që kishte partia komuniste në kohën e Titos. Po kështu kemi një kishë në kaos, të përshkruar nga luftëra të brendshme. Peshkopët grinden pa ndërprerje, luftojnë për pushtet.

- Cilat janë grupet që ndikojnë te peshkopët?

- Mund të dallohen tri grupe, para së gjithash peshkopët e Bosnjës bëjnë pjesë në krahun më radikal. Po ashtu, edhe ata të Kosovës që i kërkojnë presidentit Tadiç të hyjë në luftë për të shpëtuar Kosovën. Së fundi, kemi peshkopët e Serbisë. Këta të fundit u nënshtrohen presioneve të shtetit dhe të kishës ruse. Në Beograd kemi dy ambasada ruse: njëra e federatës, ndërsa tjetra e kishës ortodokse ruse. Kisha ortodokse ruse ka një ambasador të plotfuqishëm. Një prift mes nesh është kolonel i shërbimeve sekrete.

- Çfarë e ardhme i duhet kishës ortodokse serbe?

- Ajo që na duhet është ndërrimi i strukturës së vetë kishës ortodokse. Në kompleksin e saj ka mbetur mbrapa në Rusi, Bullgari dhe Rumani. Kisha është fosilizuar gjatë rrjedhjes së shekujve. Nuk ka kryer reforma; vëllezërit tanë katolikë kanë pasur konçilin e Vatikanit. Duhet t'i përshtatemi kohës. Kisha duhet t'u flasë njerëzve të sotëm. Nuk mund të jemi më skllëvër të së kaluarës".

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

1. **Babinger, F.** Maonetto il Conquistatore e il suo tempo. Giulio Einaudi editore Torino 1957.
2. **D'Avril, A.** La Serbie Chrétienne étude historique, Paris, 1897
3. **Dogo, M.** – Kosovo, Albanesi e Serbi: le radici del conflitto, 1992
4. **Jireček, I.C.** Geschichte der Serbien.(Amsterdam Verlag 1967)
5. **Jireček, C.** La civilisation Serbe au moyen age , Paris, 1913
6. **Chopin, Ubicini A.** Provinces Danubiennes et Romaines, Part 1-2, Paris, Firman Didot Frères MLCCCLV, /1856/
7. **Aleks N. Dragnich** and Slavko Todorovich. The saga of Kosovo focus on Serbian – albanian relations. East Europe an monographs, boulder distributed by Columbia University Press, New York, 1984
8. **Drançolli, J.** Rrënjët e qytetimit iliro – shqiptar në Kosovë. Rilindja 10-12 shkurt 1999.
9. **Sestieri, C.P.** Chiese Medievali nel Kosovo, Albania, N. 11.1942.
10. **Garde, P.** Vie e mort de la Yougosllavie, Librairie Arthème Fayard 1992.